


**SPECIFIKIME TEKNIKE TE VEÇANTA PER MENYREN E REALIZIMIT
TE MBUSHJEVE NE ARGJINATURA/DIGA**

1. Per realizimin e punimeve te dherave ne germim apo mbushje, të argjinaturave /digave, në të gjitha rastet , më parë eshte e detyrueshme të bëhet perpunimi i bazamenteve duke realizuar së pari, skarifikimet , dhe largimet e materialeve te papërshtatshem.
2. Mbas shpyllezimit dhe shkuljes se rrënjeve do te realizohet germimi per skarifikimin me trashesi **jo me pak se 20 cm.** i te gjithe siperfaqeve qe zihen nga germimi i zones ku do te krijohen mbushjet ne formen e argjinaturave/digave.
3. Trungjet e pemeve rrënjët dhe dherat e dala nga shpyllezimi dhe skarifikimi për aresye te permbajtjeve mjaft te larta organike nuk do te depozitohen brënda sheshit te ndertimit por do te nxirren e sistemohen jashtë kesaj zone.
4. Mbushja per realizimin e argjinatures/diges do te realizohet vetem pasi te jete kryer me pare skarifikimi i gjithe siperfaqes qe do te zihet prej saj sipas **pik.2.e te jete dhenë leja nga mbikeqyrësi i punimeve.**
5. Materiali mbushes i argjinatures do te realizohet me nje material mix i cili do te perfitohet nga perzjerja ne nje mase (**në %**) te caktuar me dhera argjilore plus ato zhavorore, nje perzjerje e tiilë, e cila ne trupin e argjinatures duhet te plotesoje keto kerkesa teknike:
 - Pesha volumore e skeletit **$\gamma > ose = 1.6 \text{ gr/cm}^3$**
 - Lagështia optimale **16 % (me tolerance $\pm 5 \%$)**
6. Paraprakisht ne funksion te materialeve qe do te sigurohen , do te behen prova (kontrolle) me analiza laboratorike per të përcaktuar nje raport optimal të perzjerjes te dherave argjilore me zhavoret.



Fillimisht sugjerohet qe të fillohet me nje raport 3:1 (ne baze te nje pervoje te fituar ne objekte të ngjashme) dhe, më tej në funksion te parametrave qe perfitohen nga kjo perzjerje pas provës , percaktohet raporti i sakte i perzjerjes .

7. Pasi janë bërë provat laboratorike , dhe janë garantuar parametrat e mësiperm mund te filloje mbushja per realizimin e argjinatures.
8. Paraprakisht, në nje vend depozitimi (ne nje shesh të vecante) do te behet perzjerja e materailit, dhe me tej ky materiail do te transportohet per mbushjen e argjinatures, duke u hedhur në argjinature me shtresa, me trashesi jo me shume se **20-25 cm**
9. Per te provuar peshën volumore te skeletit te realizuar, per cdo volum prej **2-300 m3** dhera te ngjeshura ne veper, nga ana e firmes zbatuese duhet te bëhet nje analize në nje laborator të specializuar per te konfirmuar peshen volumore te skeletit të realizuar në fakt, nepermjet tre kampioneve te marre ne zona te ndryshme te zones ku eshte realizuar volumi perkates.

----- o -----

